

Ligjëratë nga lënda:

Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci Moderne

Përmbledhje ligjërate IV

Politika e jashtme

- Politikat e jashtme janë strategjitë që përdorin qeveritë për të udhëhequr veprimet e tyre në drejtim të shteteve të tjera. Procesi i politikës së jashtme është tërësia e mënyrave të veprimit dhe organizimeve që përdorin shtetet për të arritur te vendimet e politikës së jashtme e te zbatimi i tyre.
- Në modelin e arsyeshem të vendimmarrjes, zyrtarët zgjedhin veprimin, rrjedhojat e të cilit ndihmojnë në mënyrë më të mire për arritjen e qëllimeve të përcaktuara të shtetit. Përkundrazi, në modelin e procesit të organizuar, vendimet rrjedhin prej mënyrave të pëtditëshme administrative të veprimit, kurse në modelin e përpjekjeve të qeverisë për marrëveshje (ose politikë të nëpunësve), vendimi rrjedh prej bisedimeve zyrtare ndërmjet agjencive qeveritare të cilat kanë interesa të ndryshme për përfundimin ku do të arrihet.
- Veprimet e vendimmarrësve të veçantë ndikohen nga personaliteti, vlerat dhe besimet e tyre, si edhe nga faktor të zakonshëm psikologjikë që shmangen prej arsyeshmërisë. Këta faktorë përfshijnë keqpërceptimin, përceptimin përzgjedhës, njëanshmëritë që lidhen me ndjenjat dhe njëanshmëritë njohëse (që përfshijnë përpjekjen për të pakësuar mospërputhjen njohëse).
- Vendimet e politikës së jashtme ndikohen prej psikologjisë së grupeve (përfshirë “mendimin në grup”), mënyrave të përdorura për marrjen e vendimeve e rolit të pjesëmarrësve.
- Gjatë krizave, mundësitë për keqpërceptime e gabime shumëfishohen.
- Luftërat për drejtimin e politikës së jashtme ndërmjet nëpunësve profesionistë e politikanëve janë të zakonshme, po ashtu si edhe ndërmjet agjencive të ndryshme qeveritare.
- Zonat zgjedhore të brendshme (grupet e interesit) kanë interesa të dallueshme në politikat e jashtme e shpesh organizohen politikisht për t’i lartësuar këto interesa.
- Të spikatura ndër këto zona zgjedhore, sidomos në SHBA e në Rusi në periudhën e Luftës së Ftohtë, kanë qenë komplekset ushtarako-industriale që përbëhen prej industrive ushtarake e industrive të tjera që kanë interes për shpenzime të mëdha ushtarake.
- Opinioni publik ndikon mbi vendimet e qeverisë për politikën e jashtme (më shumë në demokraci se sa në shtete unitare), por qeveritë edhe e manipulojnë opinionin publik.
- Historikisht, demokracitë kanë bërë po aq luftëra sa edhe shtetet autoritare, por demokracitë nuk kanë luftuar pothuaj kurrë kundër demokracive të tjera. Kjo quhet paqe demokratike.